



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 61

Prishtinë, më 06.11.2012, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu, Rasim Demiri dhe Danush Ademi

Mungoi: Rexhep Selimi

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli dhe Zarife Aliu

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 14.09.2012;
3. Shqyrtimi i Raporteve informuese të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Kosovës lidhur me veprimet e Policisë së Kosovës, me datë 17 dhe 18 tetor 2012;
4. Njoftim nga ana e grupit punues për punëtorinë e mbajtur lidhur me hartimin e Projektligjit për Komisionerin Parlamentar për Siguri;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e rendit të ditës.

1. Miratimi i Rendit të ditës.

Kryetari i Komisionit- Filloi takimin e radhës së Komisionit, me miratimin e Rendit të Ditës i cili u miratua pa ndryshime.

Gjithashtu i uroi mirëseardhje si anëtar të Komisionit, z. Danush Ademi, nga koalicioni Kosova e Re si dhe shprehi mirënjohje për z. Emin Gerbeshi, i cili ka qenë deri tani anëtar i Komisionit, dhe fjalën ia kaloi z. Gerbeshi.

Emin Gerbeshi- Vlerësoi se gjatë punës si anëtar i këtij Komisionit është bërë punë e duhur, si dhe falënderoi për bashkëpunimin dhe punën të gjithë anëtarët.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 14.09.2012

Kryetari i Komisionit- Konstatoi miratimin e Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 14.09.2012, i cili u miratua me disa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raporteve informuese të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Kosovës lidhur me veprimet e Policisë së Kosovës, me datë 17 dhe 18 tetor 2012.

Kryetari i Komisionit- Fillimisht falënderoi angazhimin e Inspektoratit Policor të Kosovës për zbardhjen e rastit në dhomën e dëshmime në Pejë, duke shprehur që ky angazhim duhet të vazhdoj deri në fund, në mënyrë që nga ky proces të dalin rezultate pozitive. Gjithashtu theksoi se një angazhim i tillë duhet të bëhet edhe në rastin e dhomës së dëshmime në Prishtinë.

Ndërsa për raportet e paraqitura në Komision, nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Kosovës, i konsideroi si përshkruese të ngjarjeve të 17-18 tetorit, duke theksuar se këto raporte nuk i janë referuar në mënyrë të saktë kërkesës së bërë nga ana e Komisionit, pasi në kërkesën drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, është kërkuar të sqarohet se: Pse Ministri ka dhënë urdhrin? Pasi sipas Ligjit të Policisë, nenit 5, përcakton kompetencat e Ministrit dhe të Drejtorit të Policisë.

Për raportet e paraqitura, tha se në të dyja këto raporte u ngjasojnë raporteve të mëhershme nga Ministria e Punëve të Brendshme, pasi nga Komisioni janë kërkuar raporte të veçanta nga dy institucionet, Ministria dhe Policia, për ngjarjet e 17-18 tetorit dhe sqarimin për zhvillimet gjatë protestave të Lëvizjes Vetëvendosje. Gjithashtu tha se është kërkuar të sqarohet arsye, se pse deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk janë lejuar të hyjnë në objektin e Qeverisë së Kosovës, për të cilën gjë nuk është dhënë sqarim i mjaftueshëm.

Në përfundim të këtij konstatimi, tha se raportit i konsideron si përshkruese dhe se nga IPK-ja, do të kërkohet që të ndërmarr masat ndaj atyre zyrtarëve policor që kanë tejkaluar kompetencat. Gjithashtu e përmendi çështjen e prezencës së një numri të madh të zyrtarëve policor në hapësirat e Kuvendit të Kosovës, për të cilën gjë nuk është

njoftuar titullari i këtij institucioni, duke shmangur bashkëpunimin institucional. Në vazhdim ftoi anëtarët për kontributin e tyre për raportet e paraqitura.

Anton Quni- Pas ngjarjeve të 17-18 tetorit tha se, nga ana e anëtarëve të Komisionit është bërë një vlerësim i tyre, ndërsa pas marrjes së raporteve nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Kosovës, po të njëjtin qëndrim mban edhe sot.

Tutje shtoi se në momentet kur në Kuvendin e Kosovës, deputetët po përgatiteshin për të debatuar për Rezolutën për normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, ai tha se në ambientet e Kuvendit vërehej një klimë jo normale siç ishte prezenca e theksuar e policëve brenda dhe jashtë Kuvendit. Gjithashtu përmendi deklaratën e Ministrit të Punëve të Brendshme ndaj deputetëve dhe autoriteteve të larta shtetërore, sipas tij krijonin imazhin e një shoqërie që udhëhiqet nga një aparat i dhunshëm diktatorial.

Tutje theksoi se demonstrimi i forcës para qytetarëve dhe demonstruesve është pjesë e luftës speciale për ushtrimin e presionit dhe frikës ndaj atyre që shprehen ndryshe nga qëndrimet qeveritare. Gjithashtu vlerësoi se në këtë situatë Policia e Kosovës është keq përdorur, duke iu nënshtruar urdhrave të udhëheqësve politik, duke vlerësuar se në momentet kur duhet një unifikim për çështjen nacionale, ata bëjnë që forcat politike të polarizohet dhe shoqëria në tërësi.

Në vazhdim ai tha se angazhimi i forcave të policisë pranë Kuvendit të Kosovës dhe kërcënimet e pa matura, janë sulm ndaj vlerave demokratike. Si anëtar i Komisionit kërkon që Policia e Kosovës të përdoret vetëm sipas ligjeve në fuqi, duke iu përmbajtur detyrave sipas prioriteteve, ndërsa nga Ministri i Punëve të Brendshme kërkoi që ti thërras ndërgjegjes si normë morale, ti kërkoj falje qytetarëve dhe ti mbaj duart larg komandimit të Policisë së Kosovës.

Gjithashtu vlerësoi se vetëm me normalizimin e situatës, raportet e brendshme mund të krijojnë parakushtet për normalizimin me fqinjët dhe se në të kundërtën shpenzimi i energjisë do të bëhet duke u marrë me vetveten.

Fatmir Xhelili- Fillimisht kërkoi që të dihet mënyra e punës së Policisë së Kosovës e bazuar në Ligjin për Policinë e Kosovës, Tutje shtoi se Policia e Kosovës e ushtron punën e saj bazuar në ligj, ndërsa veprimet adekuate dhe masat paraprake, në rastet e paralajmërimeve për protesta, e cila mund të jetë ditur në bazë të informatave inteligjente, nga ana e policisë, bëhet vlerësimi dhe merren masat paraprake dhe që janë në përputhje me mundësin për manifestimin e dhunës.

Ndërsa për zinxhirin komandues dhe këtij raporti mes Kuvendit të Kosovës dhe policisë, tha se në bazë të Ligjit për Policinë, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri dhe Presidenti, nuk kanë të drejtën e dhënies së urdhrave direkt ndaj policisë. Tutje tha se bazuar në ligjet në fuqi, paralajmërimi për protestë duhet të bëhet brenda një afati kohor, duke u treguar arsye dhe qëllimi i protestës. Gjithashtu vlerësoi se policia veprimet i ndërmerr në përputhje me zhvillimet në vendin e ngjarjes dhe në rast se eprori konstaton se duhet përdorur forca proporcionale, konform ruajtjes së sigurisë.

Në vazhdim theksoi se duhet të merren parasysh pasojat e mundshme që sjellin veprime të tilla të disa protestuesve, ku në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes ndërshtetërore përpiqen të ndërhyjnë. Tutje tha se veprimin e policisë e konsideron në përputhje me

kërkesat e momentit për të vepruar, gjithashtu tha se nuk e përjashton mundësinë e tejkalimit të forcës nga ndonjë zyrtar policor, për të cilat raste IPK-ja mund të bëj hetime. Tutje vlerësoi se gjatë protestës së 17-18 tetorit ka pasur sjellje të disa protestuesve që kanë cenuar integritetin e jetës së policëve, gjithashtu vlerësoi se raporti nuk është i plotë duke qenë se nuk janë bërë pyetje specifike drejtuar Ministrit, por është përshkruar dhe se për më shumë sqarime mund të ftohet Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë.

Vjollca Krasniqi- Për raportet e paraqitura, tha se Ministria e Punëve të Brendshme, asnjëherë nuk raporton në mënyrë korrekte, për asnjë nga ngjarjet për të cilat menaxhohen nga kjo Ministri në bashkëpunim me Policinë e Kosovës. Gjithashtu tha se raportet e paraqitura janë përshkruese, duke e theksuar vetëm numrin e personave të arrestuar gjatë protestës dhe duke i veçuar rastet e lëndimeve të zyrtarëve policor.

Në vazhdim duke iu referuar raportit të Ministrisë, tha se në të thuhet se *”nuk qëndron konstatimi juaj se ka pasur veprime të policisë së Kosovës kundër deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje”*. Nga ajo çfarë është parë, tha se ka pasur deputet të lënduar të cilët janë parë në media, gjithashtu ajo vlerësoi se është ushtruar dhunë ndaj deputetëve dhe se konstatimi i Komisionit për këtë gjë qëndron.

Tutje duke iu referuar raportit, nëse Ministri i Punëve të Brendshme ka tejkaluar kompetencat e tij, ajo tha se çështja nëse ai ka marrë instruksione nga Drejtori i Policisë për të dhënë urdhër për largimin e protestuesve e konsideroi tejkalim të kompetencave nga ana e Ministrit.

Kryetari i Komisionit- Për kërkesën e cila i është drejtuar Ministrit të punëve të Brendshme dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, tha se është bërë në emër të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe mbikëqyrje të FSK-së, dhe se adresimi i këtij raporti i është bërë Komisionit. Pas këtij diskutimi, ai tha se në një nga takimet e radhës do të ftohet Ministri i Punëve të Brendshme në Komision, për të sqaruar për ngjarjet e sferës së sigurisë.

Në vazhdim, përmendi rastin e vizitës së zyrtarëve serb në veri, sic ishte vizita e Aleksandër Vulin, i cili në territorin e Kosovës ka hyrë pa paralajmërim dhe se një veprim i tillë është në kundërshtim me ligjet në fuqi. Gjithashtu shtoi se është edhe një kërkesë për Inspektoratin Policor, që të sjell raport për masat e ndërmarra ndaj atyre që kanë tejkaluar përgjegjësitë.

Goran Marinković- Për raportet e paraqitura nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, tha se tregojnë një pasqyrë të ngjarjeve që kanë ndodhur me 17-18 tetor. Tutje tha se raporti i paraqitur nga Ministri nuk është i plot por përshkruar, gjithashtu shtoi se Policia e Kosovës ka vepruar sipas mandatit të saj në rastet kur rrezikohet siguria e institucioneve, ndërsa për veprimet e Ministrit të Punëve të Brendshme, tha se ka pasur qëllim mbrojtjen e interesit shtetëror.

Ndërsa sa i përket vizitës së zyrtarëve serb në Kosovë, tha se duhet të pajisen me lejen përkatëse për të hyrë në territorin e vendit, por nuk u pajtua me konstatimin se vizita e Aleksander Vulin mund të nxis urrejtje etnike, pasi të gjithë kanë qëllim stabilizimin e situatës. Tutje tha se pajtohet që Inspektorati Policor i Kosovës të njihet me rastet, kur

policia tejkalon kompetencën në punën e saj, në mënyrë që tensione të tilla të mos ndodhin.

Në vazhdim përmendi çështjen e vendkalimit kufitar në Merdare, në të cilin qytetarët serb hasin vështirësi në rastet kur me vete kanë tabelat dhe dokumente të cilat i përdorin kur hyjnë në territorin e Serbisë. Për këtë arsye tha se, nëse ftohet Ministri i Punëve të Brendshme në Komision për të raportuar për situatën e ndodhu, të ftohet edhe Kryeshefi i IPK-së, që të shqyrtohet situata në vendkalimin kufitar dhe sjelljes së disa zyrtarëve policor në këtë pikë.

Fatmir Xhelili- Për punën dhe vendimmarrjen në Polici, tha se bëhet në bazë të disa parimeve dhe rregullave. Në rastet kur parashikohen ndonjë protestë, caktohet Komandanti Operativ që udhëheq operacionet dhe që është urdhërdhënës, gjithashtu tha se caktohet Komandanti Taktik, i cili duhet të jetë prezent në vendin e ngjarjes, dhe në bazë të situatës, ai merr urdhra vetëm nga Komandanti Operativ.

Ndërsa për situatën në veri, tha se si Komision si dhe nga ana e institucioneve duhet kërkuar nga EULEX-i, që të jetë këmbëngulës në zbatimin e ligjit dhe që ti koordinoj aktivitetet me KFOR-in, pasi arrestimi i një qytetari në veri dhe dërgimi pranë organeve të gjyqjesis të Serbisë konsiderohet si ndërhyrje në punët e brendshme të një shteti.

Ndërsa për raportimin e Ministrisë të Punëve të Brendshme në Komisionin, tha se pajtohet me këtë propozim, gjithashtu shtoi se fajësia e çdo veprimi është e dyanshme, prandaj konsideroi se do të ishte e nevojshme të bëhen disa ndryshime në Ligjin për Siguri Publike, pasi në vendet përëndimore është e përcaktuar me ligj distanca e lejuar nga institucionet e rëndësishme shtetërore gjatë protestave, duke shmang cenimin e institucioneve publike.

Anton Quni- Tha se shumica e çështjeve nga ky takim iu adresuan Ministrisë të Punëve të Brendshme dhe jo performancës së Policisë së Kosovës, duke shmang kritikën ndaj strukturës komanduese ndaj Policisë. Ndërsa për adresimet që i bëhen Ministrisë, ai tha kjo bëhet për arsye se konsiderohet se ka pasur ndërhyrje në procedurat dhe procesin e vendimmarrjes së policisë. Për këtë arsye ai tha se Ministri duhet ta konsideroj Policinë e Kosovës si institucion që është në shërbim të gjithë qytetarëve, ndërsa për paraqitjen publike të tij gjatë protestave, duhet të jetë i kujdesshëm, pasi kjo krijon tensione mes protestuesve dhe policisë.

Fatmir Xhelili- Për përshkrimin e z. Quni, i cili tha se rrethanat e krijuara gjatë protestave, ngjasonin me një shtet policor dhe autoritar, tha se në deklaratime të tilla si deputet të Kuvendit të Kosovës duhet të jemi të kujdesshëm dhe se si anëtar të këtij Komisioni duhet kontribuar në përmirësimin e relacioneve të sektorëve të sigurisë dhe zinxhirit komandues, në nivelet politike dhe ekzekutive.

Kryetari i Komisionit- Tha se për Komisionin e rëndësishme është që institucionet që mbikëqyr të veprojnë sipas ligjit, ndërsa në rastin e protestave të 17-18 tetorit është parë një ndërhyrje nga ana e Ministrisë të Punëve të Brendshme, të cilën e ka bërë publike. Ndërsa për Policinë e Kosovës tha se si institucion që mbron sigurinë e qytetarëve, institucioneve, ndërsa për realitetin i cili është parë, nuk përbë një imazh të mirë.

Tutje theksoi se institucionet e Kosovës, duhet të jenë përgjegjëse në rastet e arrestimeve të qytetarëve nga një shtet tjetër, pasi mënyra e hyrjes cenon rendin kushtetues të vendit. Në përfundim të kësaj pike, tha se vlerësimet e dhëna nga ana e anëtarëve të Komisionit për raportin, shkojnë në raport të funksionalizimit të institucioneve, ndërsa në takimet e radhës do të caktohet takimi me Ministrin e Punëve të Brendshme dhe Kryeshefin e IPK-së, për të cilën gjë janë dakord të gjithë anëtarët e Komisionit dhe e konsideroi të mbyllur këtë pikë të rendit të ditës.

4. Njoftim nga ana e grupit punues për punëtorinë e mbajtur lidhur me hartimin e Projektligjit për Komisionerin Parlamentar për Siguri.

Kryetari i Komisionit- Tha se për njoftimin e grupit punues për hartimin e Projektligjit për Komisionerin Parlamentar për Siguri, në mungesë të Kryesuesit, z. Rexhep Selimi, njëri nga anëtarët mund të njoftoi për këtë punëtori dhe punën e bërë.

Anton Quni- Tha se për hartimin e kornizës ligjore për Komisionerin për Siguri, rolit dhe përgjegjësitë e këtij institucioni, grupi ekspertëve dhe stafi mbështetës i Komisionit, është bazuar në disa modele të vendeve që e aplikojnë këtë mekanizëm dhe sugjerimet e autoriteteve që janë marrë me këtë çështje, është arritur deri tek krijimi i draftit të parë për Ligjin e Komisionerin për FSK-në dhe Policinë e Kosovës.

Tutje tha se ky draft përmban 27 nene dhe përbën një bazë të mirë ligjore për krijimin e këtij institucioni, i cili në takimet e radhës të grupit punues do të plotësohet dhe më pas me miratimin e Komisionit do të jetë i gatshëm të paraqitet në Kuvend.

Kryetari i Komisionit- Tha se pas një pune të bërë, do të vazhdohet në konsolidimin e plotë të këtij ligji për të cilën gjë Komisioni do të kontribuoj.

5. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit- Ftoi anëtarët e Komisionit nëse kanë ndonjë çështje për të ngritur në këtë pikë.

Fatmir Xhelili- Për rrjedhën e punës së Grupit punues për mbikëqyrjen financiare të institucioneve të sigurisë, tha se është hasur në disa vështirësi, kjo për shkak të mungesës së eksperiencës dhe metodologjisë në këtë sferë. Tutje kërkoi që të realizohet një takim me përfaqësuesit e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, bashkë me anëtarët e këtij grupi, për ndërmarrjen e hapave të mëtutjeshëm.

Kryetari i Komisionit- Njoftoi anëtarët e Komisionit për takimin me përfaqësues të Ambasadës Norvegjeze në Kosovë, të cilët kanë projekt për mbështetjen e FSK-së, dhe se Komisioni do të angazhohet në këtë projekt për ngritjen e kapaciteteve të FSK-së.

Luanda Domi (Zyrtare e Projektit të DCAF)- Njoftoi për vizitën studimore që do të realizohet në Vjen dhe që mbështetet nga DCAF, nga data 9-13 dhjetor 2012. Gjithashtu gjatë kësaj vizite do ti kushtohet rëndësi edhe trajnimeve për Ombutspersonit për forcat e armatosura, për të cilën gjë grupi punues do të përfshihet. Gjithashtu njoftoi për tryezën

që do të organizohet nga DCAF, me datë 14 tetor 2102, në të cilën është i ftuar Komisioni.

Kryetari i Komisionit- Për vizitën studimore në Vjen, tha se nga ana e Komisionit do të bëhen përgatitjet e duhura, në mënyrë që kontributi në të jetë pozitiv.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi